



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
Drejtoria e Urbanistikës dhe Strehimit

Nr. Prot 3476/1

Kuçovë, më 9/11 / 2016

Lënda: Mbi reflektimin e komenteve/ sugjerimeve të Raportit të Vlerësimit Teknik të AKPT-së për Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Kuçovë dhe dorëzimin e dokumentacionit të PPV-së për deklaratën e përputhshmërisë.

Drejtuar: Znj. Adelina Greca,
Drejtoreshë e Përgjithshme
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Për dijeni: Z. Kevin McLaughlin,
Drejtor i Projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore, PLGP.
Adresa: Rr. "Dervish Hima", 3 Kullat pranë Stad. "Qemal Stafa", Kulla Nr. 1,
Apt. 91, Kati 10, Tiranë.

E nderuar Znj. Greca,

Ju falenderojmë për dërgimin e Raportit të Vlerësimit Teknik të Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit të bashkisë Kuçovë, përmes shkresës suaj me nr 1516/01 prot datë 20.10.2016, me lëndë "Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, bashkia Kuçovë" të protokolluar pranë institucionit tonë me nr 3476 datë 24.10.2016. Në përgjigje të kësaj shkrese, ju lutemi gjeni bashkëngjitur dookumentacionin e plotë të PPV-së së Bashkisë Kuçovë, në të cilin janë reflektuar komentet tuaja, të përbërë nga:

- a) Një DVD me dokumentacionin me përmbajtje si në vijim:
 - 1- Dokumenti i PPV- së
 - 2- Plani i Investimeve Kapitale
 - 3- Rregullorja e PPV- së (teksti dhe Pasaportat në format tabelar A3)
 - 4- Hartat në formatin A3
 - 5- Hartat në formatin A0
 - 6- Raporti shoqërues i GIS dhe metadatave
 - 7- Raporti Përfundimtar i VSM

- b) Një DVD që përmban të dhënat në platformën GIS sipas datamodelit të Regjistrit të Integruar të Territorit.

Gjithashtu, bashkëlidhur kësaj shkrese, gjeni edhe përshkrimin e reflektimit të sugjerimeve/ komenteve tuaja sipas Raportit të Vlerësimit Teknik të AKPT-së.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin Tuaj,

KRYETARI I BASHKISË
Selfo KAPLLANI

